



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 882/2 Prot

Tiranë, më 30.12.2020

V E N D I M

Nr.221, datë 30.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të lirit nga shërbimi civil të nëpunëses *** , për shkak të ristrukturimit të institucionit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësja ***** , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirit nga detyra, për shkak ristrukturimi,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 882 prot., datë 13.11.2020, nëpunësja ***** ka ngritur disa pretendime, për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të Komisionit të Ristrukturimit dhe të njësisë përgjegjëse, për lirim e saj nga detyra, për shkak ristrukturimi të institucionit.

Nga verifikimi i kryer për këtë rast, rezulton se nëpunësja ***** , ka përfituar statusin e nëpunësit civil në pozicionin “Specialist finance” në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Gjirokastër (si pjesë e strukturës së ish ISHMPUT). Kjo marrëdhënie punësimi, ka

vijuar ashtu si për nëpunësit e tjerë të këtij institucioni, deri në momentin e shkrirjes së ish Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoratit Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit, Ujrave dhe Turizmit dhe riorganizimit të këtij shërbimi, nëpërmjet Vendimeve nr. 568, 569, 570 e 571, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”*; *“Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”*; *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”* dhe *“Për Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”*.

Në kuadër të implementimit të akteve të mësipërme, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Turizmit (ISHMPUT) kaloi në proces ristrukturimi, i cili është karakterizuar nga pakësimi i njësive organizative dhe bashkimi ose shkrirja e tyre (u shkurtua numri i Agjencive Rajonale të Mjedisit: nga 12 rajone në 4 të tilla), duke u shoqëruar kjo edhe me suprimime të vendeve të punës (pakësim të personelit), ndryshime të përshkrimit të pozicioneve të punës dhe sidomos të kërkesave të veçanta për këto pozicione të mbetura, apo krijuar rishtas.

Ndodhur në këto kushte, të shkurtimit të ndjeshëm të vendeve të punës, Komisioni i Ristrukturimit ka analizuar rastin e nëpunëses *****, krahas nëpunësve të tjerë, në raport me pozicionet e reja të krijuara në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, duke mbajtur parasysh dispozitat e Kreut II, pika 18, të vendimit nr.125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar; të Kreut II, pika 19, të aktit nënligjor të sipërcituar, siç janë: a) vjetërsia e nëpunësit civil në shërbimin civil; b) vlerësimet e rezultateve në punë dhe c) vlerësimi i fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe për përditësimin e njohurive shtesë dhe dispozitat e udhëzimit të DAP nr. 1, datë 01.03.2016 *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*.

Më tej, Komisioni i Ristrukturimit pasi ka shqyrtuar edhe mundësinë e sistemimit të punonjësve në fjalë, në institucione të tjera të shërbimit civil, brenda distancës prej 45 km, duke analizuar edhe kriteret specifike të këtyre pozicioneve, ka arritur në përfundimin se, nuk ka patur vende vakante të së njejtës kategori në institucione të tjera të shërbimit civil në rrethin e Gjirokastrës, për të cilat nëpunësja plotësonte kriteret e veçanta, për faktin se institucionet e shërbimit civil të këtij rrethi kanë një numër shumë të limituar të vendeve vakante.

Pasi është analizuar në mënyrë shteruese çdo mundësi e paraqitur, duke iu referuar përshkrimeve të punës dhe kriterëve specifike të këtyre pozicioneve, Komisioni i Ristrukturimit nuk ka arritur të gjejë zgjidhje prandaj, me vendimin nr. 5176/2 prot., datë

21.10.2020, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunëse, mbi bazën e të cilit ka dalë dhe akti përkatës i njësisë përgjegjëse, duke parashikuar edhe përfitimet që rrjedhin nga përmbajtja e pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit të lirimit nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi, të nëpunëses ***** , dhe meqënëse nuk u gjendën elementë paligjshmërie, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha